

RAPORTI TEKNIK

“Rikonstruksion I Bllokut të sallave operatore dhe sallës operatore të shërbimit të Urgjences”

“Novatech Studio”shpk


INFORMACION I PERGJITHSHEM

- Hyrje


Sektori i Bllokut të Sallave Operatore, si dhe Salla Operatore e Sherbimit të Urgjencës si strukture brenda S.R.SH., përfaqëson qendren kryesore të ofrimit të kujdesjes për pacientet në zonën e Veriut të Shqipërisë. Shërbimet kirurgjikale, obstetrikale / gjinekologjike dhe të urgjencës janë të vetmit që ofrojnë kujdesje mjekësore të nivelit Rajonal. Për këtë arsye nga ana e M.SH. dhe Drejtorisë së S.R.SH., zhvillimi i këtij sektori është konsideruar si një përparesi strategjike. Zhvillimi i këtij sektori përveç paisjes me aparataturat e nevojshme diagnostike dhe kurative, furnizimit të rregullt me medikamente e materiale të ndryshme mjekimi, kualifikimit të vazhdueshëm të personelit të mesëm dhe të lartë, kërkon edhe ndërtimin e strukturave të përshtatshme operatore. Në këtë kontekst rikonstruksioni i këtij blloku operator është i nevojshëm për të përmirësuar cilësinë e shërbimit ndaj pacientëve, krijimin e kushteve të përshtatshme operatore për pacientet dhe stafin mjekësor, në përputhje me Kartën e të Drejtave të Pacientit dhe standartet bashkëkohore.

GJENDJA AKTUALE

S.R.SH. ndodhet në pjesën verilindore të qytetit Shkoder dhe përbehet nga kompleksi i ndërtësive



Blloku operator ndodhet në katin përdehe, sipas planimetrise së mëposhtme:



Ndertimi i tyre eshte realizuar ne vitet 2000, 2001, dhe deri tani nuk i eshte nenshtruar asnje rikonstruksioni.

Volumet e punes qe kane realizuar keta sherbime jane:

- Sherbimi i planifikuar rreth 1600 nderhyrje ne vit, ose rreth 530 nderhyrje ne vit per nje Salle Operatore.
- Sherbimi i obstetrike/gjinekologjise rreth 800 nderhyrje ne vit

Salla operatore e sherbimit te Urgjences ndodhet ne katin perdhe te godines se ketij sherbimi, sipas planimetrise se meposhtme:

Ndertimi i saj eshte realizuar ne vitet 2000, 2001, dhe deri tani nuk i eshte nenshtruar asnje rikonstruksioni.

Volumi i punes qe ka realizuar ky sherbim eshte:

- Sherbimi i Salles Operatore te Urgjences rreth 700 nderhyrje ne vit.

Sherbimet e mesiperme sot paraqesin nevoja per rikonstruksion te plote per te realizuar krijimin e kushteve te pershtatshme operatore per pacientet dhe stafin mjekesor, sepse sot nuk respektojne asnje nga kushtet minimale te funksionimit ne parametra teknike:

- Zgjidhja funksionale dhe zonimi duhet te pershtaten me mire ne funksion te levizjes se duhur per pacientin dhe stafin mjekesor.
- Gjendja e tapetit PVC bakterologjik, ne Sallat Operatore, e cila ne mjaft vende eshte e demtuar; fusha ekuipotenciale e Sallave Operatore eshte jashte parametrave teknike, si rezultat i shkeputjes se percjellesve te konturit tokezues.


- Gjendja e tapetit PVC bakterologjik, ne ambientet ndihmese, e cila ne mjaft vende eshte e demtuar.
 - Mbyllja hermetike e Sallave Operatore, ku sistemi i dyerve eshte pothuaj jashte perdorimi, si dhe hapësira drite e dyerve.
 - Sistemi i tavanit te varur ne Sallat Operatore dhe ne ambientet ndihmese.
 - Sistemi i dyerve dhe mungesa e akses kontrollit.
 - Sistemi i koromaneve dhe mbrojteseve murale qe edhe ku ekzistojne jane te demtuara.
 - Sistemi i gazrave mjekesore, aktualisht me priza per gazra mjekesore te inkorporuara brenda ne mure.
 - Sistemeve ndihmese, garderobe, sistem larje para dhe pas operator.
- Garancise se furnizimit me energji elektrike, aktualisht vetem me sistem motor-gjenerator joautomatik, ne rast te stakimit te energjise elektrike nga O.S.SH.E.E., apo te ndonje defekti te mundshem ne linjen e T.U. te furnizimit me energji elektrike.
- Sistemit ngrohje/ftohje, me pompe nxehtesie (Çiller), i cili nuk funksionon.
 - Sistemit te aspirimit, i cili nuk arrin te aspiroje Sallat Operatore dhe te trajtuesit te ajrit, i cili nuk funksionon.
 - Sistemi i ngrohjes me kaldaje, i cili ka nevojte per nderhyrje ne radiatoret ngrohës.
 - Sistemit te ndriçimit dhe fluksit te drites, ne Sallat Operatore dhe ambientet ndihmese.
 - Sistemit M.K.Z dhe te sinjalizimit nga zjarri, i cili edhe aty ku ekziston nuk funksionon.

PROJEKTI ARKITEKTONIK


Per te permiresuar funksionimin e sherbimeve per Bllokun e Sallave Operatore eshte parashikuar te behen :

Vendosje tapeti PVC bakterologjik, ne Sallat Operatore, duke realizuar shtrese dysHEMEJE konduktive me koloreks EC 250228, me gushen konduktive me koloreks EC 228, ne lartesi $h = 20.0$ cm. Me perpara realizohet autonivelimi.

Vendosje tapeti marmoleum ekzistues ne ambientet e tjera, duke realizuar shtrese me marmoleum Real 2.5 mm, ne lartesi $h = 20.0$ cm. Me perpara realizohet autonivelimi.



Ne Sallat Operatore, eshte parashikuar tavan te varur me panele çelik te lyer me puder poliester ne te bardhe, i elektrogalvanizuar, me refleksion drite mbi 80 %, me karakteristika zeizoluese deri 38 db, me rezistence ndaj zjarrit klasa 0, sipas Dm 14.01.1985 (Italiane), spesori 8 mm, moduli 600 x 600 mm, me strukture mbajtese te kryqezuar, te fshehur, guarnicioni fiksues te jete i kompletuar me profil perimetral. Korniza perimetrale profil i paralyer, i fiksuar çdo 45 cm.



Ne ambientet e tjera, eshte parashikuar tavan te varur me pllaka minerale 60 x 60 cm, me ngjyre te bardhe, me profile ne dukje (ekologjike per ambiente sterile). Struktura mbajtese te jete e kryqezuar, e fshehur.

Muret e brendshme ne Sallat Operatore, eshte para si domosdoshmeri te realizohen me Veshje muri me PVC antibakteriale ONYX 0,9 mm


Rinovimi i mureve te brendshme ne ambientet e tjera, duke realizuar procesin e rifiniturave lysterje e mureve te brendshme dhe tavane me boje antibakteriale, e percaktuar per objekte mjekesore; viskozitet 60000 cps ne 25 °C ± 6000; peshe specifike 1.55 ±1.6 kg/l ±0.05. Ngjyra percaktohet ne bashkepunim me Autoritetin Kontraktor.

Dyert e sallave operatore duke realizuar dyer batente, me nje flete, me permasa (1x150/210 cm), automatike, Te jene te prodhuara dhe te testuara ne perputhje me standartet DIN 18650. Te jene te pershtateshme per perdorim me frekuence te larte. Dera te kete hapje ne gjeresi minimumi 150 cm (1x150). Dera dhe aksesoret e saj te jene te percaktuara per ambiente spitalore dhe te kene siguri te larte ne pune, me zhurma minimale. Dera me aksesoret e saj te krijoje mbyllje hermetike te ambienteve qe ndan. Komandimi i deres ne te dy krahet realizohet me pulsant elektrik per prekje me dore, berryl. Dera do te jete inox me hapje xhami me rreze R=20 cm, ne lartesine h=160 cm. Xhami te jete antiviolent, δ = 6 mm, i tejdukshem dhe i kokrrizueshem ne thyerje. Porta duhet te jete si me poshte: -Kompatibile elektromanjetike 89/336/CEE,92/31/CEE,93/68/CEE (EN 50081-1:1992;EN 50082-1:1992); - Tension i ulet 73/23/CEE; - (EN 60204-1.1992 ;EN 60335-1 :1995).

Dyert ndihmese te sallave operatore duke realizuar dyer batente (me piston), me permasa 100x210 cm dhe 80x210 cm. Te jene te pershtateshme per perdorim me frekuence te larte. Dera te jete e paisur ne te dy krahet me doreze te kromuar, me gjatesi 30-40 cm. Dera dhe aksesoret e saj te jene te pershtateshme per ambiente spitalore dhe te kene siguri te larte ne pune me zhurma minimale. Dera te jete d/alumin plastike me hapje xhami me rreze R=20 cm, ne lartesine h=160 cm. Xhami te jete antiviolent, $\delta = 6$ mm, i tejdukshem dhe i kokrrizueshem ne thyerje. Brava e deres te jete me gjuhe sferike. Ngjyra e deres dhe te kashes prej d/alumini vendosen ne bashkepunim me Investitorin. Elementet e d/aluminit te jene standart ISO 9001:2008.

Zevendesimi i vetratave duke realizuar vetrata d\alumini plastike me dopio xham , dritare duke realizuar dritare d\alumini plastike me dopio xham, shoqeruar me grila d\alumini me rrjete per dritare.

Do te parashikohet vendosja e lavamaneve kirurgjikal komplet inox, me dy poste (gropa), me ngrohje uji me mishelator elektrik deri 60°C, me permasa afersisht 65 x 85 x 135 cm. Çdo post (grope) te kete edhe sistem dezifektanti. Komandimi i ujit dhe i sistemit te dezifektantit ne çdo post (grope) te realizohet me sensor elektrik ose me pulsant elektrik qe komandohet me kembe ose gju.



Kontroll , riparimi dhe kollona i impjantit ekzistues ne korridor dhe ambiente ndihmese.

• **FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE**

- - Lidhja me rrjetin e energjise do te behet nga rrjeti i godinës ekzistuese.
- -Të parashikohet që në cdo kat furnizimi të bëhet me 3 kablllo me seksione sipas fuqisë së instaluar:
- -Kabllot dhe percjellsat duhet te jene te tipit qe te mos e perhapin zjarrin si dhe te mos leshojne gazra te demshme per njeriun

• **INSTALIMET E RRJETIT ELEKTRIK TË NDRICIMIT**

- Të gjithë ndricuesat do të jenë me llampa neoni për të realizuar kursim maksimal të energjisë elektrike. (Keto ndricues te jene me ndezje elektronike
- -Të parashikohet seksioni i përcjellësit në varësi të gjatësisë së linjës dhe normës teknike të lejuar të rënies së tensionit në përcjellës për ndricuesit që punojnë me llamba neoni duke shtrirë në tuba 3 përcjellës; faza, nuli, tokëzim mbrojtës.

INSTALIMI I RRJETIT ELEKTRIK TE PRIZAVE DHE PAISJEVE

- -Nga paneli i TU deri tek kasete elektrike në kat, kablli elektrik të jetë 3 fazor me 3 përcjellës për fazat, 1 përcjellës për nulin dhe 1 përcjellës për tokëzimin mbrojtës.
- Për linjat elektrike në pjesën kasetë elektrike- kuti derivacioni seksioni të jetë jo më i vogël se 4 mm² dhe për paisjet elektrike të zakonshme seksioni të jetë 2.5mm², duke përdorur linjë të vecantë për cdo prizë të tipit shuko (16A-250V) dhe deri në 3 copë njëra pas tjetrës për priza të tipit bivalente (10A-250A)

INSTALIMI I RRJETIT TE VEZHGIMIT ME KAMERA

- Do të parashikohet ndërtimi i rrjetit te sistemit te monitorimit me kamera i lidhur me NVR e sistemit ekzistues te monitorimit, duke përdorur kamerat dhe NVR ekzistuese.
- Do të parashikohet shtimi i kamerave te reja per mbulimin e plote te te gjithë ambienteve

- Do të parashikohet ndërtimi i rrjetit të transmetimit dhe të ushqimit për cdo kamer që instalohet me kablllo me parametra teknike të përshtatshëm për sistemin e monitorimit dhe regjistrimit.
- Do të parashikohet instalimi i te gjithë aksesoreve përkatës në një ambient shërbimi 24 orë.
- **INSTALIMI I SISTEMIT MNZ**
- - Do të parashikohet instalimi i një rrjeti të sinjalizimit të sistemit MNZ i përbërë n sensorët e tymit dhe temperaturës, sirenat e jashtme dhe të brendshme, i lidhur me centralin ekzistues te godines.
- -Rrjeti i sensorëve, sirenave, butonave të parashikohet të instalohen mbi tavanin e varur të mbrojtur në tub plastik z.d, i fortë e fleksibël dhe të jetë antizjarr i gradës së tretë.
- -Të parashikohet instalimi i një sensori për 60-80 m² sipërfaqe. (një sensor i zakonshem mbulon nje siperfaqe deri ne 80 m2)

Heqje , riparim ,montim ,kolaudim I rrjetit te gazrave mjekesore sistem oksigjen O2, sistem protoksid azoti N2O, sistem dyoksid karboni CO2, sistem vakumi, sistem aspirimi, me panele te reduktimit te presionit te nivelit te dyte me bypass, te sinjalizimit nga rrjedhjet, si dhe ndrimi i Prizave O2 dopio; - Priza N2O dopio; - Priza CO2 tek; - Priza AC4 dopio; - Priza Vakumi tek.

**PËR “Novatech Studio” SH.P.K.
ADMINISTRATORI**

Ing. Emil Nova